




USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA



Programi për Ndërmarrësit e Rinj

Shpall Thirrjen e Parë për Ndërmarrësit FILLESTARË për
Zhvillimin e Aftësive të Ndërmarrësisë
dhe për Aplikim për Grante

BËHU NDËRMARRËS

Give Life
to Your
Idea!

Jepi jetë
idesë
tënde!

Oživi
svoju
ideju!

APLIKO ONLINE

www.usaidyep.org

Programi për Ndërmarrësit e Rinj inkurajon gratë, minoritetet dhe personat me nevoja të veçanta që të aplikojnë.

PROGRAMI

Qëllimi i Programit të USAID-it për Ndërmarrësit e Rinj (YEP), i zbatuar nga Education Development Center, Inc. (EDC), është që të promovojë dhe mbështesë zhvillimin e bizneseve të reja të fuqishme që do t'i kontribuojnë zhvillimit ekonomik dhe krijimit të vendeve të punës.

-- BËHU NDËRMARRËS --

QASJA PËR NDËRMARRËS FILLESTAR

Programi do të mbështesë të rinjtë që kanë nevojë për aftësim në zhvillimin e ideve novatore dhe për ndihmë në zhvillimin e bizneseve fillestare përmes hulumtimit të mundësive për biznes dhe marketing dhe duke ofruar mbështetje në planifikimin e biznesit, në kontabilitetin bazik dhe në praktikatat më të mira menaxheriale.

Me këtë thirrje të parë programi kërkon 200 ndërmarrës ambiciozë që do të marrin mbështetje përmes Kursit për Zhvillimin e Aftësive në krijimin e planeve të biznesit. Planet e biznesit do tu paraqiten përfaqësuesve të institucioneve financiare, stafit të Programit për Ndërmarrësit e Rinj dhe akterëve relevantë në fushën e biznesit. Kur të jenë përzgjedhur planet e qëndrueshme të biznesit, ndërmarrësit do të sigurojnë së paku 50% të kapitalit nga burimet e veta (fondet mund të jenë nga kursimet personale, kreditë, investimet në sektorin privat ose dhuratat) dhe mund të marrin një grant në shumë të njëjtë nga Programi për Ndërmarrësit e Rinj.

KUSH MUND TË APLIKOJË NË KËTË THIRRJE TË PARË?

Të rinjtë e moshës 18-35 vjeç nga Prishtina, Fushë Kosova, Obiliqi, Drenasi, Lipjani, Graçanica dhe Podujeva, të cilët i plotësojnë këto kritere minimale:

- Të kenë një ide biznesi,
- Të jenë të përkushtuar për të punuar shumë në zhvillimin dhe zbatimin e planit të biznesit, dhe
- Të jenë të gatshëm që të fillojnë biznesin e ri dhe të kenë qasje në fonde personale në shumë të njëjtë.

SITË APLIKONI?

Hapi 1: Vizitoni www.usaidyep.org

Hapi 2: Klikoni butonin “**Apliko Online**”

Hapi 3: Klikoni butonin “**Apliko Këtu**”, për të filluar me plotësimin e aplikacionit

*Për udhëzime se si duhet aplikuar, ju lutem klikoni në butonin “**Si të Aplikoni**”*

Për më shumë informata rreth programit, ju lutem klikoni butonin

*“**Udhëzuesi për Fondin Fillestar për Ndërmarrës**”*

Nëse keni probleme në lidhje me plotësimin e aplikacionit apo keni ndonjë pyetje rreth përmbushjes së kriterëve minimale, ju lutem dërgoni një email me titull “Kërkesë për Ndihmë” në adresën: seedfund@usaidyep.org

Afati i fundit për aplikim është 24 nëntor 2011. Numri është i kufizuar. Aplikoni tani!

PROCESI I PËRZGJEDHJES PËR KETË PROGRAM

- 1) Të gjitha aplikacionet për qasjen për ndërmarrës FILLESTAR do të verifikohen se a i përmbushin kriteret minimale.
- 2) Aplikuesit që e kalojnë procesin e parë të verifikimit do të ftohen që të marrin pjesë në një trajnim njëjavor për Orientim në Ndërmarrësi.
- 3) Pas javës së orientimit bëhet një test i aftësive për të përcaktuar shpirtin sipërmarrës të një aplikuesi.
- 4) Pjesëmarrësit që shfaqin një shpirt të fortë sipërmarrësi, do të gëzojnë të drejtën që të përfitojnë nga një kurs tre-javor për Zhvillimin e Aftësive të Ndërmarrësisë.
- 5) Pjesëmarrësve do tu ofrohet mbështetje praktike profesionale që idetë e tyre të biznesit t'i zhvillojnë në plane të suksesshme biznesi për t'ia paraqitur Komisionit për Shqyrtimin e Planeve të Biznesit.
- 6) Planet e qëndrueshme të biznesit të aprovuara nga komisioni do të kenë të drejtë të marrin grantin në shumë të njëjtë me fondet që i posedojnë si dhe ndihmë teknike e cila ofrohet nga Programi YEP.

ÇKA OFRON PROGRAMI PËR NDËRMARRËSIT E RINJ?

- Zhvillim të aftësive të ndërmarrësisë dhe këshilla biznesi për të gjithë individët e kualifikuar për të përmirësuar planet e tyre të biznesit, në pajtim me kërkesat aktuale të tregut.
- Mbështetje për prezantimin e planit të biznesit para komisionit për shqyrtimin e planeve të biznesit, i cili përbëhet nga institucionet financiare, stafi i programit dhe njerëzit e tjerë të biznesit.
- Lidhjet me dhe referimin në bankat komerciale dhe në institucionet mikrofinanciare.
- Një grant mesatar prej 6,500 USD, i barabartë me fondet e vet ndërmarrësit, pasi të jetë aprovuar plani i qëndrueshëm i biznesit.
- Trajnim, mentorim dhe mbështetje të vazhdueshme teknike deri në 12 muaj për fituesit e grantit të cilët fillojnë një biznes të ri.

Give Life
to Your
Idea!

Jepi jetë
idesë
tënde!

Oživi
svoju
ideju!

“Kjo broshurë është realizuar me përkrahjen zemërgjerë të popullit amerikan përmes Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Përmajtja është përgjegjësi e Education Development Center, Inc. (EDC) dhe nuk pasqyron domosdo pikëpamjet e USAID-it ose të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.”

Për informata të më tutjeshme, ju lutem kontaktoni:

Programin për Ndërmarrësit e Rinj

www.usaidyep.org

+381 38 742 318 / 319

+377 45 700 801



www.facebook.com/usaidyep